



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 tetor 2023
Nr.ref.: RK 2279/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI20/22

Parashtrues

Sadullah Dërmaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës
së Kosovës, Pml. nr. 469/2021, të 29 dhjetorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sadullah Dërmaku, nga Komuna e Dardanës, të cilin e përfaqëson Shemsedin Pira, avokat në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 469/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 216/2021] e 29 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe me Aktgjykimin [PKR. nr. 133/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht kërkon pezullimin e Aktgjykimit [Pml. nr. 469/2021] të 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 44 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018 do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 shkurt 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 21 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit GJR. KSH. KI20/21 caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 7 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.

10. Më 30 mars 2022, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dorëzoi Gjykatës Supreme.
11. Më 28 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata informatë se në cilën fazë të procedurës është shqyrtimi i kërkesës së tij nga Gjykata.
12. Më 1 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës për herë të dytë kërkoi nga Gjykata se në cilën fazë të procedurës është shqyrtimi i kërkesës së tij nga Gjykata.
13. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 10 nëntor 2017, Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) ngriti Aktakuzën [PP. I. nr. 224/2017] përmes të cilës parashtruesi i kërkesës akuzohej se ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
15. Më 13 prill 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 215/17] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së dhe të njëjtit i shqiptoi (i) dënimin me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve; (ii) dënimin me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro; si dhe (iii) dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas mbajtjes së burgut; si dhe (iv) e detyroi që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit.
16. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, përkatësisht shkelje të nënparagrafëve 1.10 dhe 1.12 të paragrafit 1 të nenit 384 [Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale] në lidhje me nenin 370 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPPK), me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të themeltë dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.
17. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 13 prillit 2018, ankesë ushtroi edhe Prokuroria Themelore për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i rëndë, konkretisht dënim me burgim efektiv.
18. Më 14 qershor 2018, Prokuroria e Apelit paraqiti shkresën [PPA/I. nr. 273/2018] në Gjykatën Themelore duke kërkuar aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore.
19. Më 13 gusht 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 293/18] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe rastin e riktheu për rigjykim në Gjykatën Themelore.
20. Gjykata e Apelit përmes aktvendimit të saj arsyetoi se: *“Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit dhe sipas detyrës zyrtare gjeti se aktgjykimin e atakuar duhet anuluar nga arsyeja se i njëjti përmban shkelje esenciale*

të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par.1. nënparagrafi 1.12, lidhur me nenin 370 ngase i njëjti nuk është përpiluar në formën e paraparë me ligj dhe se rrethanat të cilat janë marrë për bazë me rastin e shqyrtimit të dënimit nuk kanë të bëjnë me të [parashtruesin e kërkesës] por me personat tjerë andaj dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin ngase ka të bëjë me personat të ndryshëm e nga kjo del se nuk janë dhënë arsye mbi fakte vendimtare”.

Procedura e parë e rigjykimit

21. Më 31 janar 2019, Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën penale – ndihmë në kryerjen e veprës penale dhe veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 33, paragrafi 1 në lidhje me nenin 428, paragrafin 1 të Kodit Penal dhe të njëjtit iu shqiptua dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, si dhe e detyroi atë që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit.
22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të themeltë dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje. Kundër këtij Aktgjykimi, ankesë ushtroi edhe Prokuroria Themelore e mbështetur edhe nga Prokuroria e Apelit për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozimin që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, dhe parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i rëndë.
23. Më 25 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019]: (i) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 171/18] e 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së; dhe (iii) vendosi që rastin ta kthejë në rigjykim në Gjykatën Themelore.
24. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj sqaroi se: *“Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e tij, sepse në dispozitiv të aktgjykimit konstatohet se gjykata e shkallës së parë e ka shpallur të akuzuarin fajtor, për shkak të veprës penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 33, par.1 lidhur me nenin 428, par. 1 të KPRK-së, në arsyetimin e aktgjykimit (faqja 3, fjalia e fundit dhe faqja 4), taksativisht thuhet”. Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, trupi gjykues konstaton: se i akuzuari [parashtruesi i kërkesës], me dashje e ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit, nga neni 428, par. 1 të KPRK-së ...”, që është në kundërshtim të plotë me cilësimin juridik të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor në dispozitiv të aktgjykimit. Po ashtu, kjo kontradiktë e evidente në mes dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit është manifestuar edhe në faqen 9, pasusi i parë, rreshti i fundit kur gjykata përfundon se:” ... nga provat e administruara trupi gjykues është i bindur se janë përmbushur elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428, par. 1 të KPRK-së”.*

Në fakt, nga arsyetimi i Aktgjykimit nuk rezulton se gjykata e shkallës së parë ka bërë ricilësimin e veprës penale të marrjes së ryshfetit në atë të ndihmës në kryerjen e kësaj vepre, sepse siç rezulton nga përshkrimi faktik i arsyetimit të aktgjykimit por edhe nga provat në shkresat e lëndës i akuzuari ka vepruar vetëm dhe nuk ekziston asnjë person tjetër që i akuzuari të ketë mundur ta ndihmojë në ndonjë mënyrë siç parasheh neni 33 i KPRK-së.

Këto kundërthënie janë aq të theksuara në aktgjykim sa e bëjnë atë të paqartë, konfuz dhe juridikisht të paqëndrueshëm dhe të cilat paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1 nënpar. 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së e që paraqet bazën ligjore për anulim të aktgjykimit, ngase janë të natyrës absolute dhe nuk mund të evitohen në këtë procedurë, sepse e bëjnë të pamundur vlerësimin e drejtë të ligjshmërisë së aktgjykimit në fjalë. [...]

Procedura e dytë e rigjykimit

25. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 69/2019], parashtroi kërkesën e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së dhe të njëjtit iu shqiptua dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro dhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas mbajtjes së burgut, si dhe të njëjtin e detyroi që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtroi kërkesën kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 69/2019] të 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të themeltë dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje. Kundër këtij Aktgjykimi, ankesë ushtroi edhe Prokuroria Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë.
27. Më 17 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 634/2019]: (i) anuloi Aktgjykimin [PKR.nr. 69/2019] e 18 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore: (ii) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtresit të kërkesës; (iii) shpalli ankesën e Prokurorisë Themelore si jolëndore; dhe (iv) ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore për shkak "të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe të shkeljes së ligjit penal në dëm të të akuzuarit, pa eliminimin e shkeljeve në fjalë nuk mund të flitet për vërtetim të plotë të gjendjes faktike e as aplikim të drejtë të ligjit penal, për çka edhe kjo gjykatë vendosi që çështja në fjalë të anulohet dhe të kthehet në rigjykim".
28. Sipas Gjykatës së Apelit, "[...] pretendimet e lartcekura ankimore janë të bazuara, por, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me dispozitën e nenit 384, par.1 nënparag. 12 të KPPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes, shkelje këto të cilat së bashku me kundërthëniet e cekura edhe më lart aktgjykimin e ankimuar e bëjnë jo të ligjshëm dhe si të tillë duhet anuluar".

Procedura e tretë e rigjykimit

29. Më 26 qershor 2020, Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020], parashtroi kërkesën e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së dhe të njëjtit iu shqiptua dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro dhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të

funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas mbajtjes së burgut, si dhe të njëjtin e detyroi që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit.

30. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të themeltë dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje. Kundër këtij Aktgjykimi, ankesë ushtroi edhe Prokuroria Themelore e mbështetur nga Prokuroria e Apelit për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet dënim më i rëndë.
31. Më 15 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 340/2020] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 21-2020] e 26 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore si rezultat i shkeljes së neneve 384 dhe 370 të Kodit Penal dhe mungesës së vendimit të arsyetuar, si dhe në fund vendosi që rasti të kthehet në rigjykim në shkallë të parë dhe lënda të gjykohet nga një panel tjetër gjykues. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj arsyetoi se Gjykata Themelore në gjykimin e rastit konkret nuk ka marrë parasysh udhëzimet e dhëna përmes aktvendimeve të lartcekura të Gjykatës së Apelit.
32. Gjykata e Apelit theksoi se: “[...] duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare konform nenit 394, par. 1 të KPPK-së, gjen se ky aktgjykim, ashtu si me të drejtë pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, par. 1 nënpar. 1.12, të KPPK-së, sepse nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK-së”.
33. Gjykata e Apelit, në vijim vlerësoi se: “Gjykata e shkallës së parë nuk ka përfillur fare rekomandimet e Gjykatës së Apelit të dhëna me aktvendimet e saj PAKR nr.293/18, PAKR.142/19 dhe PAKR.634/19 duke anashkaluar jo vetëm udhëzimet e dhëna nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë por edhe duke mos dhënë arsyet e duhura lidhur me pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit e që është detyrim ligjor i gjykatës”.

Procedura e katërt e rigjykimit

34. Më 28 prill 2021, Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 133/2020]:
 - (i) parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe e dënoi me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro; (ii) i shqiptoi dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas mbajtjes së burgut; (iii) e detyroi që të paguajë paushallin gjyqësor në vlerë prej pesëdhjetë (50) eurove; si dhe (iv) e detyroi që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit.
35. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 133/2020] të 28 prillit 2021, të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të themeltë dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe

çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje. Kundër këtij Aktgjykimi, ankesë ushtroi edhe Prokuroria Themelore e mbështetur edhe nga Prokuroria e Apelit për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë.

36. Më 29 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21], ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorisë Themelore i refuzoi si të pabazuara dhe vërtetoi Aktgjykimin [PKR. nr. 133/2020] e Gjykatës Themelore të 28 prillit 2021.
37. Më 13 dhjetor 2021, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi se: vendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore është i bazuar në një provë të papranueshme; në veprimet operacionale ndaj tij kanë marrë pjesë edhe dy zyrtarë policorë J. S. dhe Sh. K., të cilat nuk kanë pasur autorizime në urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake që të ndërmerren veprime hetimore ndaj tij; dhe rrjedhimisht provat e tilla do duhej të trajtoheshin si të papranueshme.
38. Në vijim, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, pretendoi se Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit, përkatësisht në nxjerrjen e Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk kishte marrë për bazë Aktvendimin [PAKR. nr. 142/2019] e Gjykatës së Apelit të 25 prillit 2019 dhe si rezultat i kësaj në kundërshtim me nenin 395 të Kodit të Procedurës Penale e kishte dënuar atë për kryerjen e veprës penale të marrjes së rryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së, duke mos respektuar parimin *reformatio in peius*. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Themelore gjatë nxjerrjes së Aktgjykimit të saj [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk ka pasur të drejtë që ta ndryshojë rikualifikimin juridik të veprës penale dhe atij t'i shqiptojë dënim më të rëndë duke e përkeqësuar pozitën e tij, pasi që vetëm mbrojtësi i tij kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, përderisa Prokuroria Themelore kishte paraqitur ankesë vetëm përkitazi me lartësinë e dënimit.
39. Në fund, parashtruesi i kërkesës theksoi se: *“gabimin e shkallës së parë nuk e ka eliminuar gjykata e shkallës së dytë e cila ka paraqitur arsyetim të paqartë dhe të paqëndrueshëm duke potencuar faktin se bëhet fjalë për gabim teknik”*.
40. Më 24 dhjetor 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes shkresës [KMLP. II. nr. 282/2021] Gjykatës Supreme i propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
41. Më 29 dhjetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 46/2021], kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi [PML. nr. 469/2021] i Gjykatës Supreme i 29 dhjetorit 2021 është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
43. Parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Në rastin konkret konsideroj se është shkelur neni 31 i Kushtetutës, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm që mbron lirinë*

individuale të individëve që ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë. Më rastin e gjyqimit të të akuzuarit nga gjykatat nuk i është garantuar një gjykim fer, korrekt dhe i paanshëm”.

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ricilësimi i veprës penale të marrjes së ryshfetit në ndihmë sipas nenit 428 në lidhje me nenin 33 të KPK-së në procedurën e rigjyqimit, i vendosur përmes Aktgjyqimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore, përbën shkelje të parimit *reformatio in peius*.
45. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore gjatë procedurës së rigjyqimit në nxjerrjen e Aktgjyqimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk kishte marrë për bazë Aktvendimin [PAKR. nr. 142/2019] e Gjykatës së Apelit të 25 prillit 2019, por parashtruesin e kërkesës e kishte shpallur përsëri fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së, duke mos respektuar parimin *reformatio in peius*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Themelore, përmes Aktgjyqimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk ka të drejtë që ta ndryshojë rikualifikimin juridik të veprës penale dhe atij t'i shqiptojë dënim më të rëndë duke e përkeqësuar pozitën e tij në procedurë penale.
46. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikisht thekson: *“Megjithatë, gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin pasues nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë por të dënuarën e ka shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428, par. 1. të KPRK-së, duke mos respektuar parimin reformatio in peius, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur të drejtë që ta ndryshojë aktgjykimin përkitazi me rikualifikim juridik të veprës penale, gjegjësisht të përkeqësojë pozitën e të akuzuarit në këtë çështje penalo-juridike”.*
47. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“[...] Pra ta shpall fajtor dhe ta gjykojë të akuzuarin tani të dënuarën me kualifikim juridik më të rëndë të veprës penale siç ka qenë me aktgjykimin e parafundit marrja e ryshfetit nga neni 421, par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, i cili aktgjykim bazuar në shkresat e kësaj çështje penale nuk ka qenë fare i kundërshtuar nga Prokuroria Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, nga të gjitha bazat ankimore por vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, pra edhe jo për shkak të rikualifikimit juridik të veprës penale. Me një cilësim të tillë në mënyrë të drejtpërdrejtë janë cenuar rëndë të drejtat dhe liritë themelore të tija të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës”.*
48. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Gjetjet e Gjykatës së Apelit të cilat vërejtje ajo vetë ia ka sugjeruar gjykatës së shkallës së parë me aktvendimin e mëparshëm siç është theksuar tani me aktgjykimin e goditur thekson në faqen e 5 pasuesi 2 se pretendimet e mbrojtjes janë të pabazuara ngase në bazë të shikimit të dispozitivit por edhe të arsytimit të aktgjyqimit të mëhershëm rezulton se padyshim se bëhet fjalë për vepër penale të marrjes së ryshfetit e jo për ndihmë në marrjen e ryshfetit sikur që pretendohet nga mbrojtësi i të akuzuarit. Mirëpo, tek emërtimi ligjor i veprës penale pra tek aktgjykimi i mëhershëm gjykata e shkallës së parë e ka shënuar gabimisht tek emërtimi ligjor i veprës penale se bëhet fjalë për vepër penale ndihmë në marrjen e ryshfetit gjë që duke pasur parasysh se logjikisht nuk mund të flitet për një vepër të tillë ku në tërë ngjarjen ka marrë pjesë vetëm i akuzuari edhe i dëmtuari e jo edhe ndonjë person tjetër ndërmjetësues, atëherë vetëkuptohet se është fjala vetëm i gabim teknik, për çka një lëshim i tillë mund të eliminohet vetëm me një aktvendim për përmirësimin e aktgjyqimit, nga gjykata e shkallës së parë por nuk mund të flitet për ndihmë në kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit sikur që pretendon*

mbrojtësi, andaj edhe në këtë drejtim sipas gjykatës së shkallës së dytë nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara ankimore”.

49. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pohon se: *“Një arsyetim i tillë i dhënë nga gjykata e shkallës së dytë është mjaft shqetësues dhe brengosësh sepse nuk krijon siguri juridike për të akuzuarin”.*
50. Në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 216/21] e 29 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“arsyetimi për refuzimin e ankesës nuk është bindëse dhe juridikisht i paqëndrueshme”.*
51. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar, i Gjykatës Supreme është i përfshirë me mungesë të vendimit të arsyetuar dhe i njëjti është arbitrar për shkak se sipas tij gjykatat e rregulla gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale.
52. Gjithashtu në lidhje Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 469/2021 i 29 dhjetorit 2021 – se në rastin konkret është fjala për një gabim teknik ka mundur të eliminohet me përmirësimin e aktgjykimit nga Gjykata e shkallës së parë – një gjë e tillë në këtë stad nuk është e mundur”.* Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës pretendon se arsyetimi i rikualifikimit të veprës penale përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore si **“gabim teknik”** nga ana e Gjykatës Supreme përbën shkelje të nenit 371 [Gabimet e imëta në aktgjykim] të KPPK-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *“Nuk mund të arsyetohen vendimet e marra gjyqësore se është fjala për gabime teknike kur Prokurori i Shtetit nuk bënë ankesë kurse aktgjykimi anulohet vetëm sipas ankesës së mbrojtësit siç ka ndodhur në rastin konkret – pozita e të pandehurit nuk mund të përkeqësohet e në rastin konkret një gjë e tillë ka ndodhur [...]”.*
53. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij ta shpallë të pranueshme dhe (ii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. nr.34/2021] e Gjykatës Supreme duke kthyer rastin në rigjykim si dhe (iii) të miratojë masën e përkohshme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 30

[Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

(2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;

(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;

(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;

(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

KODI NR. 04/L-082 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 428

Marrja e rryshfetit

1. Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 92

Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Urdhri për ndonjë masë të caktuar nga ky kapitull i cili nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri i cili bëhet me shkrim dhe përmban:

1.1. emrin dhe adresën e personit ose të personave që i nënshtrohen urdhrit, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes;

1.2. emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;

1.3. në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale sipas nenit 19 nënparagrafi 1. 11. të këtij Kodi;

1.4. masa dhe koha e saktë e fillimit dhe përfundimit të saj nëse zbatohet, dhe

1.5. personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.

Neni 371

Gabimet e imëta në aktgjykim

Gabimet në emra dhe numra, gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, parregullsitë në mënyrën e përpilimit të aktgjykimit me shkrim dhe mospërputhja e aktgjykimit me shkrim me origjinalin, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm.

Nëse gabimet e imëta apo të padëmshme në aktgjykim janë objekt i ankesës, Gjykata e Apelit mund ta përmirësojë aktgjykimin nga neni 403 i këtij Kodi.

Kur të dhënat nga neni 365, paragrafi 1. nënparagrafët 1.1. deri në 1.4. dhe nënparagrafi 1.6. i këtij Kodi në aktgjykimin e përpiluar me shkrim ndryshojnë nga origjinali, aktvendimi për përmirësim u dërgohet personave nga neni 369 i këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati i ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme.

Neni 395

Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

54. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

56. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 (Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

57. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 469/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe i ka dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
58. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të

Rregullores se punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës, përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

59. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
60. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
61. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me Aktakuzën [PP.I. nr. 224/2017] e ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjilan kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit Penal. Gjykata po ashtu rikujton se procedura e ndjekur penale ndaj parashtruesit të kërkesës, e zhvilluar përgjatë periudhës 2018-2021, kishte rezultuar në kthimin katër herë të çështjes në rigjykim në Gjykatën Themelore. Thënë këtë, Gjykata vë në pah se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 215/17] të 13 prillit 2018, parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe dënoi atë me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro. Ky Aktgjykim ishte anuluar dhe kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 293/18] të 13 gushtit 2018. Gjykata vëren se në procedurën e parë të rigjykimit, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 171/18] parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për ndihmë në kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit sipas nenit 33 dhe 428 të KPK-së dhe rrjedhimisht atij iu shqiptua dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, si dhe dënimi plotësues - ndalim i ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes së burgut, si dhe detyroi të paguaj; shumën prej pesëdhjetë euro për kompensimin e viktimave të krimit. Ky Aktgjykim ishte anuluar dhe kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019] të 25 prillit 2019. Në

vijim të këtij Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit dhe tri vendimeve të saja [PAKR. nr. 634/2019] të 17 janarit 2020, [PAKR. nr. 340/2020] të 15 tetorit 2020 dhe [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021, respektivisht çështja ishte kthyer edhe tri herë në rigjykim në Gjykatën Themelore. Në vendimet vijuese të Gjykatës Themelore, përfshirë edhe atë të fundit [PKR. nr. 133/2020] të 28 prillit 2021, kjo gjykatë në vazhdimësi parashtuesin e kërkesës e kishte (i) shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së rryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 të KPK-së dhe dënuar me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro; (ii) shqiptuar atij dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes së burgut; (iii) detyruar që të paguajë paushallin gjyqësor në vlerë prej nga pesëdhjetë euro; si dhe (iv) detyruar që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit. Ky Aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021 dhe nga Gjykata Supreme, e cila përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 46/2021] të 29 dhjetorit 2021, kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë e refuzoi si të pabazuar.

62. Thënë këtë, Gjykata vë në pah se parashtuesi i kërkesës i konteston aktgjykimet e gjykatave të rregullta, specifikisht Aktgjykimin [Pml. nr. 46/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 216/21] e 29 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe me Aktgjykimin [PKR. nr. 133/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se të njëjtat janë në kundërshtim me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

63. Në kërkesën e tij, parashtuesi i kërkesës ngriti pretendimet thelbësore si në vijim:

- (i) shkeljen e parimit *reformatio in peius*, përmes vendimeve të kontestuar nga ana e tij, përkatësisht nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 dhe nga Gjykata Themelore në procedurën e rigjykimit përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020 e cila sipas tij nuk ka marrë parasysh vërejtjet e Gjykatës së Apelit të dhëna përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019] të 25 prillit 2019 dhe rrjedhimisht me vendimin që nxjerr Gjykata Themelore ka përkeqësuar pozitën e të akuzuarit;
- (ii) administrimin e provave në kundërshtim me ligjin; si dhe
- (iii) shkeljen e parimit për vendim të arsyetuar gjyqësor përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

64. Në dritën e pretendimeve të lartcekura, Gjykata, në vijim, do të trajtojë secilin pretendim të parashtuesit të kërkesës veç e veç, duke aplikuar në rastin e tij parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në bazë të të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

65. Prandaj, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës së parashtuesit të kërkesës do të fillojë me shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimit të parashtuesit të kërkesës që ndërlidhet me parimin e *reformatio in peius*, për të vazhduar me shqyrtimin dhe vlerësimin edhe të dy pretendimeve të tija të ngritura në kërkesë para Gjykatës.

(i) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit *reformatio in peius*

66. Gjykata fillimisht rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se ricilësimi i veprës penale të marrjes së rryshfetit në ndihmë sipas nenit 428 në lidhje me nenin 33 të Kodit Penal në procedurën e rigjykimit përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore përbën shkelje të parimit "*reformatio in peius*".

67. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Themelore gjatë procedurës së rigjykimit në nxjerrjen e Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk kishte marrë për bazë Aktvendimin [PAKR. nr. 142/2019] e Gjykatës së Apelit të 25 prillit 2019, por kishte dënuar parashtruesin e kërkesës për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit penal, duke mos respektuar përsëri parimin “*reformatio in peius*”.
68. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të parimit “*reformatio in peius*” në dëm të tij, duke specifikuar se shfrytëzimi i të drejtës së tij për ankesë nuk guxon që atij t’ia përkeqësojë pozitën gjatë zhvillimit të procedurës penale.
69. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në pah se parimi “*reformatio in peius*” i referohet garancive procedurale të vendosura të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
70. Thënë këtë, Gjykata gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës nëse është cenuar apo jo parimi “*reformatio in peius*” do të marrë parasysh: (i) procedurën e zhvilluar penale ndaj parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e saj; dhe, (ii) parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vetë Gjykatës.
71. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah parimin se drejtësia e një procedure vlerësohet në tërësinë e saj dhe rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t’i përmbahet këtij parimi (shih rastin e Gjykatës nr. KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin nr. KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
72. Thënë këtë, Gjykata po ashtu thekson se “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në kushte të njëjta në gjykatë (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
73. Në rastin konkret, Gjykata vëren se përmes vendimeve gjyqësore të nxjerra në procedurë penale ndaj tij, parashtruesit të kërkesës në vazhdimësi i ishte konfirmuar/vërtetuar fajësia dhe atij i ishte shqiptuar dënimi i njëjtë, me përjashtim në Aktgjykimin [PAKR. nr. 171/18] e 31 janarit 2019 të Gjykatës Themelore, të nxjerrë në procedurë të rigjykimit, përmes të cilit ai ishte shpallur fajtor për ndihmë në kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit sipas neneve 33 dhe 428 të KPK-së dhe atij i ishte shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, si dhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas mbajtjes së burgut. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në pah se Aktgjykimi [PKR. nr. 171/18] i 31 janarit 2019 i Gjykatës Themelore përmes të cilit pretendohet ricilësimi i veprës penale në dëm të parashtruesit të kërkesës, ishte anuluar përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019] të 25 prillit 2019 të Gjykatës së Apelit me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës në rastin për të cilin akuzohej “*ka vepruar vetëm dhe nuk ekziston asnjë person tjetër që i akuzuari të këtë mundur ta ndihmojë në ndonjë mënyrë siç parasheh neni 33 i KPRK-së*”.
74. Gjykata në vijim, vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore gjatë procedurës së tretë të rigjykimit në nxjerrjen e Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të

- 26 qershorit 2020, nuk kishte marrë për bazë Aktvendimin [PAKR. nr. 142/2019] e Gjykatës së Apelit të 25 prillit 2019, por kishte dënuar përsëri parashtruesin e kërkesës për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së, duke mos respektuar parimin *reformatio in peius*. Këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës e arsyeton se Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, nuk ka pasur të drejtë që ta ndryshojë rikualifikimin juridik të veprës penale dhe atij t'i shqiptojë dënim më të rëndë duke e përkeqësuar pozitën e tij në procedurë penale.
75. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019] të 25 prillit 2019, nga ana e Gjykatës Themelore, që rezultoi në nxjerrjen e Aktgjykimit [PKR. nr. 21-2020] të 26 qershorit 2020, i nxjerrë në procedurë të tretë të rigjykimit, Gjykata vëren se ky nuk kishte rikualifikuar veprën penale të parashtruesit të kërkesës siç ishte bërë në Aktgjykimin [PKR. nr. 171/18] e Gjykatës Themelore të 31 janarit 2019, por në fakt vetëm kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së duke ia shqiptuar atij dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro dhe dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes së burgut si dhe detyrimin që të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit. Për më tepër, Gjykata vëren se Aktgjykimi [PKR. nr. 21-2020] i 26 qershorit 2020 i Gjykatës Themelore ishte anuluar përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 340/2020] të Gjykatës së Apelit të 15 tetorit 2020, duke mos prodhuar kështu efekte juridike në rastin e parashtruesit të kërkesës.
76. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se pas kthimit të rastit në rigjykim, përkatësisht në procedurën e katërt dhe përfundimtare të rigjykimit, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 133/2020] të 28 prillit 2021:
- (i) parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i KPK-së dhe e dënoi atë me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve dhe dënim me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro;
 - (ii) i shqiptoi dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes së burgut;
 - (iii) e detyroi që të paguajë paushallin gjyqësor në vlerë prej pesëdhjetë euro; si dhe
 - (iv) e detyroi që të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro për kompensimin e viktimave të krimit.
77. Si rezultat i parashtrimit të ankesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, respektivisht, ky Aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021 dhe nga Gjykata Supreme, e cila përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 46/2021] të 29 dhjetorit 2021 kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e kishte refuzuar si të papabuar.
78. Gjykata vë në dukje se rasti i parashtruesit të kërkesës ka kaluar nëpër një sërë procedurash të gjykimit dhe rigjykimit, megjithatë vendimi i fundit dhe përfundimtar në rastin e tij është Aktgjykimi [PKR. nr. 133/2020] i 28 prillit 2021 i Gjykatës Themelore i vërtetuar edhe përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/2021] të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit [Pml. nr. 469/2021] të Gjykatës Supreme.
79. Në vijim, në lidhje me pretendimet e ngritura të parashtruesit të kërkesës para gjykatave të rregullta e që ndërlidhen me parimin "*reformatio in peius*", Gjykata i referohet

Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, e cila në adresimin e pretendimit të tij kishte theksuar si në vijim:

“Gjithashtu të pabazuara janë edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur nuk ka respektuar parimin “reformatio in peus”, ngase, me rastin e anulimit të aktgjykimit të ankimuar në rastet e mëhershme, i akuzuari ka qenë i shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit, pretendime këto që sipas kësaj gjykate janë të pabazuara, ngase, në bazë të shikimit të dispozitivit por edhe arsyetimit të aktgjykimit të mëhershëm, rezulton se pa dyshim që bëhet fjalë për vepër penale të marrjes së ryshfetit e jo për ndihmë në marrjen e ryshfetit, sikur që pretendohet nga mbrojtësi i të akuzuarit, mirëpo, tek emërtimi ligjor i veprës penale pra tek aktgjykimi i mëhershëm, gjykata e shkallës së parë, e ka shënuar gabimisht emërtimin ligjor i veprës penale, se bëhet fjalë për vepër penale në ndihmë në marrjen e ryshfetit, gjë që duke pasur parasysh se logjikisht nuk mund të flitet për një vepër të tillë [...]”.

80. Gjithashtu, edhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar [Pml. nr. 46/2021] të 29 dhjetorit 2021 gjatë adresimit të pretendimit të njëjtë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, kishte theksuar:

“Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara, përkritazi me kualifikimin ligjor të veprës penale, sipas Aktgjykimit [PKR. nr. 171/2018] të datës 31.01.2019 dhe faktin se i dënuari ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në marrjen e ryshfetit nga neni 428, par.1 të KPRK-së, dhe si pasojë e kësaj shkelje ishte anuluar ky aktgjykim, dhe me aktgjykimin që është objekt i shqyrtimit të tanishëm është shkelur parimi “reformatio in peius” pasi që me Aktgjykimin PKR.nr.133/2020 të datës 28.04.2021 është bërë rikualifikimi më i rëndë ligjor në raport me Aktgjykimin PKR.nr.171/2018 të datës 31.01.2019, gjeti se pretendimet nuk janë të bazuara”.

81. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se përmes vendimeve gjyqësore të nxjerra në procedurën e katërt dhe përfundimtare të rigjykimit, respektivisht përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 133/2020] të Gjykatës Themelore, të vërtetuar përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit [Pml. nr. 46/2021] të 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, nuk i është rikualifikuar vepra penale siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.
82. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kërkesa e “drejtësisë” siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës mbulon procedurat në tërësi, dhe pyetja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht të një incidenti të veçantë ose mangësie procedurale, ngase mangësitë e tilla në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih rastin e GJEDNJ-së, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 9562/81; 9818/82, Aktgjykim i 2 marsit 1987, paragrafët 55-70).
83. Nën dritën e shtjellimeve të sipërcekura, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të parimit *reformatio in peius*. Veç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestonte në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij ishin dëgjuar e shqyrtuar në

mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; shih po ashtu rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

84. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me cenimin e parimit të *reformatio in peius* janë qartazi të pabazuara sepse këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë e (ii) pretendimeve që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”*. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me pretendimin për administrimin e provave të papranueshme

85. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë marrë duke u bazuar në prova të papranueshme me arsyetimin se në zbatimin e Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] të gjyqtarit të procedurës paraprake në rastin e tij kanë marrë pjesë edhe dy zyrtarë policorë të cilët nuk kanë qenë të autorizuar sipas Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] që të përfshihen në rastin e tij.

86. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“[...] aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme pasi që në veprimet operacionale ndaj të dënuarit kanë marrë pjesë edhe dy zyrtarë policorë nga ana e Departamentit për Krime Ekonomike të Gjilanit dhe atë konkretisht zyrtarët policorë [J.S.] dhe [Sh.S.], përkundër faktit se bazuar në urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake UGJK. nr.405/2017, të datës 18.10.2017, këta dy zyrtarë policorë nuk ishin përcaktuar që të ndërmarrin veprime hetimore ndaj tani të dënuarit”*.

87. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Vlerësimi i dhënë nga ana e Gjykatës Supreme asesi nuk mund të trajtohet si i pranueshëm bazuar në përmbajtjen e urdhrin të lëshuar ku si persona zyrtarë të autorizuar për kryerjen e veprimeve operacionale nga kjo urdhëresë identifikohen vetëm dy persona zyrtarë policorë e jo edhe personat të tjerë zyrtarë policorë, të cilët nuk janë përfshirë dhe autorizuar me këtë urdhëresë”*.

88. Gjykata thekson se pranueshmëria e provave dhe vlerësimi i tyre në parim janë kompetencë e gjykatave të rregullta (shih rastin e Gjykatës, KI01/19, parashtrues *Fatos Rizvanolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 133-135; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Schenk kundër Zvicër*, kërkesa nr. 10862/84, Aktgjykim i 12 korrikut 1988, paragrafin 46). Gjykata vlerëson nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duke pasur parasysh edhe nëse të drejtat e mbrojtjes janë respektuar. Në veçanti, i kushton vëmendje nëse parashtruesit të kërkesës i është dhënë një mundësi për të kundërshtuar vërtetësinë e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *Bykov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, paragrafin 90).

89. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta e kishin shqyrtuar dhe i ishin përgjigjur këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, të cilat e kishin refuzuar si të

pabazuar. Specifikisht, Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 133/2020] të 28 prillit 2021 kishte konstatuar si në vijim:

"[...] Në rastin konkret gjykata gjeti se me Urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake UGJK.nr.10512017, i datës 18.10.2017, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, ish-in urdhëruar zyrtarët policorë të NJHRKEK nga Gjilani për zbatimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit ndaj Sadullah Dermaku, nën dyshimin se kishte kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 248, paragrafi 1 të KPRK-së, edhe atë katër zyrtarë policorë të cilët ditën kritike me rastin e simulimit të veprës penale kishin parë pjesë që të gjithë pa përjashtim, mirëpo për shkak të veprimeve operative në këtë simulim të veprës penale kishin marrë pjesë edhe dy zyrtarë të tjerë për të cilët zyrtarët e NJHRKEK e kishin konstatuar si të nevojshme për zbatimin e planit operativ, andaj në rastin konkret gjykata konsideron se provat e marra janë prova të pranueshme pasi që të gjithë zyrtarët policorë të cilët kishin qenë të caktuar për zbatimin e kësaj mase kishin marrë pjesë në simulimin e veprës penale ku më pastaj në flagrancë ishte arrestuar i akuzuari Sadullah Dermaku".

90. Në vazhdim, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 216/21] të 29 tetorit 2021, gjatë adresimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, të ngritur në kërkesën e tij, kishte theksuar si në vijim:

"[...] një pretendim i tillë ankimor është i pabazuar, ngase, siç rezulton nga dhe shkresat në lëndë, e konkretisht Urdhëresa e Gjykatës Themelore - DIC- në Gjilan, e cila urdhëresë është lëshuar për zbatimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe atë fotografim të fshehtë ose vëzhgim në video në vende publike dhe vende private ndaj personit të dyshuar, pra, për të akuzuarin Sadullah Dermaku, janë caktuar edhe zyrtarët për realizimin e urdhëresës në fjalë, e të cilët edhe kanë vepruar sipas urdhëresës në fjalë, kështu që edhe nëse në rastin konkret është dashur që në veprimet operacionale në fjalë të kyqet edhe ndonjë person tjetër, zyrtar, kuptohet me urdhrin e zyrtarit të policisë të caktuar nga gjykata, atëherë, nuk do të thotë se pjesëmarrja e një personit tjetër zyrtar e ve në pikëpyetje ligjshmërinë e procesit në fjalë, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit ngase, për realizimin e veprimeve operacionale nëse kërkohet numër më i madh i zyrtarëve të policisë, nuk do të thotë se duhet kërkesë e veçantë e policisë që t'i paraqitet gjykatës për pjesëmarrjen edhe të ndonjë zyrtari tjetër, për çka, pretendimet në fjalë në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara".

91. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML. nr. 469/2021] të 29 dhjetorit 2021 kishte theksuar si në vijim:

"[...] duke u bazuar në shkresat e lëndës nuk del të jetë kontestuese fakti se në zbatimin e urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake UGJK. nr. 105/2017 të datës 18.10.2017, kanë marrë pjesë edhe zyrtarët policorë [J.S.] dhe [SH.S.]. Mirëpo me këtë rast, pjesëmarrja edhe e dy zyrtarëve tjerë policorë së bashku edhe me pjesëtarët e tjerë të përfshirë në urdhër në asnjë rrethanë nuk e bëjnë zbatimin e urdhrin provë të papranueshme, pjesëmarrja e zyrtarëve policorë J. S. dhe Sh. S. ishte nën mbikëqyrjen e zyrtarëve tjerë të autorizuar policorë. Ashtu që duke u bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet "fakti se veprimet operative policore ish-in të koordinuara dhe të ndërmarra nga ana e disa zyrtarëve policorë, andaj kjo rrethanë në asnjë mënyrë nuk e bën zbatimin e urdhrin provë të papranueshme. Përndryshe bazuar në dispozitën e nenit 97, par.1 të KPPK-së është përcaktuar kushti që një provë të jetë e papranueshme edhe në rastin kur zbatimi i saj është i kundërligjshëm, mirëpo duke interpretuar dispozitën në fjalë dhe duke e ndërlidhur me pretendimin konkret, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të

Kosovës, me këtë rast zbatimi i urdhrit ishte i ligjshëm pasi që zyrtarët policorë ishin të autorizuar për zbatimin e tij, kurse pjesëmarrja edhe e dy pjesëtarëve të tjerë për shkak të operacionit më të gjerë në asnjë rrethanë nuk nënkupton se provat e marra përmes kësaj mase janë të kundërligjshme përkatësisht nuk mund të cilësohen si prova të papranueshme”.

92. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta si rezultat i administrimit të provave të nxjerra nga zbatimi i Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] të njëjtat i kishin vlerësuar si të pranueshme, duke konstatuar se zbatimi i Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] të gjyqtarit të procedurës paraprake në rastin konkret ka qenë i ligjshëm, dhe se pjesëmarrja dy e më tepër zyrtarëve policorë (J.S., dhe Sh. S.) për arsye operative nuk e ka bërë procesin kundërligjor, duke u bazuar në nenin 92 [Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimi], pika 1.5 e KPPK-së, i cili përcakton se urdhri për ndonjë masë të caktuar nga ky kapitull përmban personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.
93. Në lidhje me pretendimin për pjesëmarrjen e dy pjesëtarëve të policisë në veprimet operacionale në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës Supreme se: *“pjesëmarrja e zyrtarëve policorë J. S. dhe Sh. S. ishte nën mbikëqyrjen e zyrtarëve tjerë të autorizuar policorë”.*
94. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike nga ana e gjykatave të rregullta, duke u bazuar në prova të papranueshme të nxjerra nga zbatimi i Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] të 18 tetorit 2017.
95. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin marrë parasysh një sërë kombinim elementesh të provave përpara se të jepnin vendimet e tyre, kështu ato janë mbështetur në prova të tjera përveç provave të nxjerra nga zbatimi i Urdhrit [UGJK. nr. 105/2017] të 18 tetorit 2017, por që vërtetonin arsyet e bazuara për të arritur në përfundimin se parashtruesi i kërkesës ishte fajtor.
96. Gjykata konsideron se pretendimi për mënyrën e të vërtetuarit të gjendjes faktike duke u bazuar në provat e nxjerra nga pjesëmarrja edhe e dy pjesëtarëve tjerë të policisë të paautorizuar sipas pretendimit në fjalë - përbën çështje të faktit dhe të ligjit çka është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta. Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit, nuk mund t'i zëvendësojë vendimet e veta me ato të gjykatave të rregullta.
97. Për më tepër, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë parimisht çështje për gjykatat e rregullta, gjetjet dhe konkluzionet e të cilëve në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në dyshim (shih rastin e GJEDNJ-së, *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë, [DHM], kërkesa nr. 60654/00*, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, para. 89).
98. Nga sa më sipër, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç nëse dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mundet vetë të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një tjetri. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufijve të juridiksionit të saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale

(shih rastin e Gjykatës nr. KI13/16, parashtrues *Armend Selimi*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 tetorit 2016).

99. Prandaj, nën dritën e asaj që u tha më lart, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur këtë pretendim të tij dhe rrjedhimisht ky pretendim refuzohet si qartazi i pabazuar.

(iii) Pretendimi për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar

100. Për sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës e ndërlihdh me arsyetimin e Gjykatës Supreme.
101. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se arsyetimi/vlerësimi i Gjykatës Supreme si “gabim teknik” i Gjykatës Themelore, ku përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019, e kishte ricilësuar veprën penale të marrjes së ryshfetit në ndihmë sipas neneve 428 dhe 33 të Kodit Penal, rezulton në arsyetim arbitrar dhe rrjedhimisht përbën shkelje të nenit 371 të Kodit të Procedurës Penale.
102. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml.nr 469/2021 i 29 dhjetorit 2021 – se në rastin konkret është fjala për një gabim teknik ka mund të eliminohet me përmirësimin e aktgjykimit nga Gjykata e shkallës së parë – një gjë e tillë në këtë stad nuk është e mundur”.
103. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës specifikon se: “Në rastin konkret, mbrojtja konsideron se kemi të bëjmë me mungesë të dhënies së një arsytimi të mjaftueshëm dhe të detajuar për refuzimin si të pabazuar të pretendimeve të parashtruara me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, nisur nga fakti se mendimi i përfaqësuar i Gjykatës Supreme me rastin e vlerësimit të pretendimeve të theksuara nga ana e mbrojtjes me kërkesën e parashtruar për mbrojtje të ligjshmërisë përkitazi me rikualifikimin e veprës të cilën gjykata e vlerëson si gabimi i shfaqur teknik asesi nuk mund të pranohet duke pasur parasysh normën ligjore nga neni 371, par.1 nga e cila normë ligjore në mënyrë eksplicite vihet në pah se çka nënkuptojmë me fjalën gabim teknik dhe mënyrën e eliminimit të tyre me një aktvendim në drejtim të përmirësimit të aktgjykimit. Në këtë kuptim, mbrojtja e të dënuarit vlerëson se në këtë çështje kemi të bëjmë me aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar nga e cila ka rezultuar si pasojë edhe nxjerrja e konkluzioneve arbitrare dhe të paarsyeshme”.
104. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t’u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t’u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Suominen kundër Finlandës, kërkesa nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 37; si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16 parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 46).
105. Gjykata thekson se, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, Van de Hurk kundër Holandës, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen (shih rastet e GJEDNJ-së, Buzescu kundër Rumanisë, nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005 dhe Pronina kundër Ukrainës, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006). Po ashtu, dhënia e një

arsyeje për një vendim që nuk është një arsye e mirë në ligj nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 (shih rastin e GJEDNJ-së *De Moor kundër Belgjikës*, nr. 16997/90, Aktgjykimi i 23 qershorit 1994 si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16, parashtruesi *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 51).

106. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta adresuan pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në ankesat e tij dhe përfundimisht edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar para Gjykatës Supreme.
107. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se vlerësimi i Gjykatës Supreme si “gabim teknik” me rastin e ricilësimit të veprës penale përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 171/18] të 31 janarit 2019 i prishur përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 142/2019] të 25 prillit 2019, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar dhe nuk duket se ky vlerësim ishte vendimtar apo përcaktues për epilogun e rastit të tij.
108. Në dritën e këtyre argumenteve të Gjykatës Supreme, Gjykata konstaton se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit të tij, janë parashtruar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI128/18, parashtruesi i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019, KI129/18, parashtruesi i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, KI130/18, parashtruesi i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019).
109. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtruesit të kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parashtrësive të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.
110. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër dhe në mënyrë specifike, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, dhe se për pasojë, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor janë qartazi të pabazuara në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”.
111. Si përfundim, pas shqyrtimit të secilit pretendim veç e veç të parashtruesit të kërkesës, të ngritur në kërkesën e tij para Gjykatës, kjo e fundit konsideron se i njëjti nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

112. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe kërkesa e tij duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

113. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht kërkon pezullimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Pml. nr. 469/2021] të 29 dhjetorit 2021.
114. Megjithatë, ashtu siç është specifikuar si më lart, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, si qartazi e pabazuar.
115. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (2) të rregullit 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI107/19, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafët 88-90; KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 e KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55; dhe KI211/19, cituar më lart, paragrafi 83).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullat 34 (2), 45 dhe 48 (b) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2023, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

